REPUBLIKA E SHQIPERISE
VIOLETA FRASHERI
NOTERE
TIRANE

# AKT THEMELIMI

# I

# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

# " TRE VELLEZERIT "

XHEVDET TUFA, i biri i Haxhiut, i datëlindjes 1950, lindur e banues në Lundër të Tiranës.

Brenda identitetit të personit të mësipërm, pasi u ra dakort për të gjitha çështjet, u vendos të përpilohet ky akt konstitutiv si marrëveshje për themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mbështetur në principet e mëposhtme:

Neni 1

Formuesi(konstituenti) do të ndërtojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta emërtojë " TRE VELLEZERIT ".

Neni 2

Qendra e Shoqërisë( Selia ) do të jetë në Lundër të Tiranës.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe për mbi 10 vjet dhe të vazhdueshëm.

OBJEKT I SHOQERISE

Neni 4

Shoqëria do të zhvillojë veprimtari në drejtim të prodhimit dhe të tregtimit me shumicë dhe me pakicë të artikujve të ndryshëm alkolikë, freskuese, etj, tregtimit me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë ushqimorë, bujqësore dhe blegtorale, mishit e prodhime të mishit, materiale e lëndë ndërtimi, makineri e pajisje, import eksportit, etj.

Neni 5

Kapitali social i Shoqërisë do të jetë 100000 lekë kapital i cili investohet nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 6

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij akti themelimi edhe me dispozita të tjera të parashikuara në Statutin e Shoqërisë, statut i cili i bashkalidhet këtij akti themelimi, që do të nënshkruhet nga ortaku i vetëm dhe do të miratohet nga ana e Gjykatës së Rrethit Tiranë.

ORTAKU I VETEM
XHEVDET TUFA

# S T A T U T I
# I
# SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# " TRE VËLLEZËRIT "

FORMA , BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

Shoqëria Private"TRE VËLLEZËRIT", në poshtë e quajtur SHOQËRI, formohet nga themeluesi :

XHEVDET TUFA, person juridik, me seli në adresën, Fshati Lundër - Tiranë, për të themeluar një shoqëri tregtare në Republikën e Shqipërisë në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, SHPK, me ortak të vetëm.

Neni 2

Shoqëria është person juridik dhe është krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tillë e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar.

Neni 3

Selia e Shoqërisë është në fshatin Lundër të Tiranës. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, me zgjerimin e aktivitetit, me miratim dhe vendim të ortakut të vetëm.

Neni 4

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj, në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë filiale në vende të tjera në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës.

Neni 5

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit të investuar në të.

LIBRI I SHOQËRISË

Neni 6

Për të precizuar e për të saktësuar veprimtarinë e vetë ekonomike, dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vetë, i cili do të quhet LIBRI I SHOQËRISË.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortaku vetë, si dhe për personat që pranohen në Shoqëri, bie, dakort që të mos i ekspozojë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhi, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen.

11 fq

Të gjitha aktet dhe dokumentet e tjera që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuara për të tretët, duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë, dhe pas tij fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet "SHPK", kapitalin themelsar dhe emrin e administratorit.

OBJEKTI

Neni 9

Shiqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:
Import - eksportin, prodhimin e tregtimin me shumicë dhe me pakicë të pijeve të ndryshme alkolike, freskuese,etj,tregtimit me shumicë dhe me pakicë të artikujve industrialë,ushqimorë, bujqësorë, blegtorale, mish e prodhime mishi, materiale e lëndë ndërtimi,makineri e pajisje,etj

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 10

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe për mbi 10 vjet e të vazhdueshëm, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit kur shkrihet para kohe, për shkaqe të arsyeshme, ose të zgjatjes së këtij kufiri sipas rregullave të përcaktuara më poshtë:

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100000 lekë, Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm.
Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj, me vendim të ortakut të vetëm, themelues.

Neni 12

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve( në se do të ketë të tillë në të ardhmen), gjithashtu pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen edhe të tretëve, me vendim të ortakut të vetëm. Gjithashtu ato janë lirisht të transferueshme në rast marrje pasurore mes bashkëshorteve si dhe në rrugë trashigimie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE

Neni 13

Shoqëria do të konsiderojë qendrën e vetëme Lundër, si Shoqëria NËNË e cila rast pas rasti do të hapet edhe në filiale të tjera, ose Shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj, në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 14

Organi më i lartë i drejtimit të Shoqërisë është ORTAKU I VETEM, organi vendimor.
Shoqëria mund të administrohet nga :
- një administrator unik, aktualisht Xhevdet Tufa:
- një këshill administrativ:
Neni 15
Administratori, mund të jetë ose jo ortak, sipas përcaktimit që do të bëjë ortaku i vetëm. Administratori shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm ose kur jep vetë dorheqjen.
Neni 16
Administratori unik ose i autorizuar, i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në emër të Shoqërisë, dhe në të gjitha rrethanat.
LIBRAT E SHOQERISE
Neni 17
Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël ose librave të tjerë edhe këto libra:
- Librin e ortakut, në të cilin shënohen emri i plotë i tij, dhe kuota e kapitalit themeltar:
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit vendimor:
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit administrativ.
BILANCI
Neni 18
Bilanci mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti, ku i pari do të jetë përjashtimisht, më 31/12/1996.
Llogaritë vjetore, iventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ky i fundit. Miratimi i këtyre dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
DIVIDENTET
Neni 19
Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, përcaktohet pjesa që i takon ortakut themelues në formën e dividentit mbi fitimin.
Ky fitim përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjëanë për fondin rezervë të domosdoshëm të përaktuar nga ortaku, të fondeve të tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

MARRËDHENIAT PËR PUNËSIM

Neni 20

Kriteret e përgjithshme të punësimit të personave të tjerë, numrin e tyre, kufijtë e pagesës dhe detyrat e sejoilit në Shoqëri, përcaktohen nga ortaku i vetëm.

Punësimi i personave në shoqëri kryhet mbi bazën e kontratës individuale të punës, të hartuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 21

Shoqëria merr përsipër të përcaktojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore, për të gjithë të punësuarit nëtë, ndërsa këta të fundit duhet të pranojnë këtë statut. Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe sipas këtij statuti për moszbatimin e detyrave dhe dëmeve që ata i shkaktojnë Shoqërisë.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 22

Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar në statut, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohëshme për arsyet e parashikuara në ligjë.

Neni 23

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku i vetëm cakton një ose disa likujdues të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivit dhe të pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likujdimit, ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorëve dhe të shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit( nëse ka të tillë) likujduese ndan kapitalin për ortakun themelues.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohen të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të paraqeten për zgjidhje në Gjykatën kompetente Shqiptare, konform legjislacionit shqiptar.

Neni 25

Shtimi i ortakëve

Kur ortaku vetëm është dakort që të bëhen shtesa kapitali me anë të personave të tjerë, që këta të konsiderohen ortakë, duhet të veprohet kështu :

- së pari merret vendim nga ortaku i vetëm ku shqyrtohet kërkesa e të interesuarit, bëhet pranimi dhe përcaktohet kuota e kapitalit

që do të derdhet nga ortaku i ardhshëm.
- së dyti, bëhet regjistrimi në librin e ortakut, ku shkruhet emri i plotë i ortakut të ri dhe kuota në kapitalin social.
- Veprimi i bashkimit të ortakut të ri duhet të bëhet me akt noterial

Neni 26

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i rzferohet plotësimeve të mëtejshme me anë amendamentesh sa herë që e sheh të arsyeshme ortaku i vetëm, themelues i kësaj Shoqërie, person juridik me seli në Lundër. Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën bëhet vetë nxjerrja e këtij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik të Shoqërisë.

PER SHOQERINE " TRE VELLEZERIT "SHPK
ORTAKU I VETEM
Xhevdet Tufa

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 996 Rep
Nr 923 Kol

V E R T E T I M

Vertetohet se sot më datën 29/01/1996 në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqitë personalisht Xhevdet Tfa, i pa njohur prej meje, për identitetin e të cilit u sigurova nga letër njoftimi i tij personal, i cili më deklaroi se sa më sipër është një statut i shoqërisë së krijuar prej , statut i cili u hartua me vullnetin e tij të lirë e të plotë dhe e nënshkroi atë rregullisht.

N O T E R E

Violeta Frashëri